



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.12/2024

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj kryesues, Hajriz Hoti, Kujtim Pasuli, Hidajete Gashi Alaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lista Srpska, me seli në Mitrovicë të Veriut, të paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 09 shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 25.12.2024, merr këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET** e bazuar ankesa e subjektit politik Lista Srpska, me seli në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

**II. ANULOHET** Njoftimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), i datës 23.12.2024, **URDHËROHET** Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ta certifikon subjektin politik Lista Srpska dhe kandidatëve të këtij subjekti politik, sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ të datës 22.12.2024, për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 09 shkurt 2025.

## A r s y e t i m

Me datë 24.12.2024 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjektit politik Lista Srpska me seli në Mitrovicë të Veriut, me të cilën theksohet se subjekti politik Lista Srpska brenda afatit të paraparë me ligj ka dorëzuar aplikacionin përmes platformës online, përmes llogarisë së saj të përdoruesit në Zyrën për Regjistrim, Konfirmim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (KRPFKPS) për konfirmimin e listës së kandidatëve për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025.

Në ankesë është theksuar se më datë 22.12.2024, Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (KRPFKPS) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë një rekomandim në të cilin thuhet se subjekti politik Lista Srpska ka dorëzuar dokumentacionin në përputhje me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregullat shoqëruese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku në pikën një (1) të rekomandimit, theksohet se në përputhje me rregullën zgjedhore numër 04/2004 për konfirmimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, subjekti politik Lista Srpska ka përmbushur

detyrimet e parapara me ligj duke dorëzuar dokumentacionin në vijim "1.1. deklaratë politike" dhe "1.2. listë i kandidatëve me 48 kandidatë me formularë dhe aplikime për secilin prej kandidatëve" duke theksuar se lista përmban tridhjetë e dy (32) kandidatë meshkuj ose (67)% dhe gjashtëmbëdhjetë (16) kandidate femra ose (33)%.

Në pikën dy (2) të rekomandimit në të cilin është bërë verifikimi i të dhënave sipas nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (KRPFKPS) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç parashihet në nenin 30 të Ligjit nr. 08/L228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të verifikimit të listës së kandidatëve të subjektit politik Lista Srpska, iu drejtuan institucioneve në vijim: Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Ministria e Punëve të Brendshme.

Në pikën tre (3) të rekomandimit e zyrës pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve konstatohet si më poshtë: Pas verifikimit paraprak të ndërmarrë nga Zyra dhe pas marrjes së informacionit nga institucionet përgjegjëse për verifikimin, siç përcaktohet në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 17 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Zyra rekomandon KQZ-në: "Certifikimin e subjektit politik SRPSKA LISTA dhe kandidatëve të këtij subjekti politik (shtojca 1) për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025".

Parashtruesi i ankesës thekson se pavarësisht këtij rekomandimi, më 23 dhjetor 2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka certifikuar subjektin politik Lista Srpska dhe as nuk ka marrë vendim të arsyetuar për këtë, por përmes një emaili të datës 23.12.2024, në orën 17:09 ka marrë informacionin e mëposhtëm: Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i dërgoi KQZ-së rekomandim për verifikimin e subjektit politik Lista Srpska dhe kandidatëve. Lidhur me këtë rekomandim, KQZ-ja nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, andaj e kanë njoftuar se nuk janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025, dhe e kanë udhëzuar në të drejtë për ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Parashtruesi i ankesës ka propozuar që PZAP ta miratoi ankesën si të bazuar dhe të vërtetoj se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të mos certifikuar subjektin politik Lista Srpska dhe kandidatët e tij për deputetë është jo ligjor dhe antikushtetues, se është në kundërshtim me nenet 31 dhe 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me nenet 16, 17, 26, 27 dhe 30 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe të URDHËROJË Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të certifikoj dhe konfirmoj subjektin politik Listën Serbe dhe të gjithë 48 kandidatët e saj për deputetë, në pajtim me Ligjin nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar në mbledhjen e saj të mbajtur me datën 23.12.2024

Zyra ka rekomanduar 17 subjekte politike me listë të kandidatëve për certifikim, në mesin e tyre edhe subjektin politik Lista Srpska me gjithsej 48 kandidat, ku rekomandimi i zyrës ka përmbajtur shpjegimin e shkruar për secilin kriter ligjor të përmbushur nga aplikuesi konkretisht nga subjekti politik Srpska Lista. Andaj konform dispozitave ligjit për zgjedhje pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ me vendim miraton ose refuzon aplikimin për certifikim të subjekteve të caktuara, varësisht nga rekomandimi i zyrës. Neni 63.4 i LZP-së shprehimisht thekson se për rregullat zgjedhore, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e partive politike, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe për vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e rezultateve, KQZ-ja vendos me konsensus, përveç kur kjo është e pamundur atëherë vendoset me dy të tretat (2/3) e votave, ndërsa çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të votave. Me tej thekson se pas diskutimeve të shumta në këtë takim KQZ në mungesë të konsensusit për marrjen e vendimit sipas nenit 63.4 të LZP-së duke mos arritur 2/3 e votave për miratim dhe rekomandim të zyrës, nuk ka mundur të marr asnjë vendim lidhur me certifikimin apo refuzimin e subjektit politik Lista Srpska dhe kandidatëve të tyre. Më saktësisht pas votimit ku 2 vota ishin për, 2 vota ishin kundër dhe 7 abstenime, lidhur me rekomandimin për certifikimin e subjektit politik Srpska Lista nuk është marr vendim, sepse vendimet merren me shumicë të votave apo në rastin konkret me 2/3 e votave, **por është konstatuar se rekomandimi për certifikim i subjektit politik Lista Srpska nuk ka kaluar dhe për këtë në kuptim të paragrafit 5 të nenit 17 të LZP-së aplikuesi është njoftuar me email për mos kalimin e rekomandimit dhe është udhëzuar për parashtrimin e ankesës.**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, njoftimit të KQZ-së të datës 23.12.2024 dhe përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezultojnë se: subjekti politik Lista Srpska, me kandidatët e saj për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, ka përfunduar aplikimin për certifikim si subjekt politik përfshirë edhe listën e kandidateve në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ.

Sipas rekomandimit të datës 22.12.2024 të Zyrës së lartcekur, është rekomanduar se subjekti politik Lista Srpska, së bashku me kandidatët e këtij subjekti politik i ka plotësuar kushtet ligjore për tu certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025.

KQZ-ja, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ në mbledhjen e mbajtur me datë 23.12.2024, nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për certifikimin e subjektit politik në fjalë, përkatësisht është konstatuar se rekomandimi për certifikimin e Listës Srpska nuk ka kaluar pasi që pas votimit 2 vota kanë qenë për, 2 vota kanë qenë kundër dhe 7 abstenime, andaj në rastin konkret nuk është nxjerr vendim duke mos arritur 2/3 e votave për miratimin e rekomandimit të zyrës.

Në këtë rast KQZ nuk ka nxjerr vendim lidhur me refuzimin për certifikimin e subjektit politik ankues por ka lëshuar njoftim, mirëpo Paneli ka pranuar që të vlerësoj ankesën në meritat të saj jo duke u fokusuar në emërtimin e aktit por në përmbajtjen dhe efektin e tij, që në këtë rast është pranuar se njoftimi ka prodhuar efekt dhe ka krijuar pasoja të drejtpërdrejta për subjektin politik në fjalë duke mos e certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025. Një praktikë të tillë të vlerësimit të akteve sipas përmbajtjes dhe efektit ka ndërtuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastet Nr. KO 159/21 dhe KO 160/21 datë 03.07.2023.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në njoftimin e datës 23.12.2024, nuk mund ta pranoi si të drejt dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë meqenëse i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike, me konkretisht nenit 16 të LZP-së, i cili përcakton, Kushtet për certifikimin e subjekteve politike të cilat subjektet politike duhet të plotësojnë në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhje. Në nenin 16 paragrafi 5 parashihet se *“KQZ-ja e certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së.....”*.

Me dispozitat e nenit 17 par. 1 i LZP-së parasheh se *“Zyra shqyrton të gjitha aplikimet dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara me nenin 16, të këtij ligji, atëherë Zyra është e obliguar që dhjetë (10) ditë pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik lidhur për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm”*. Neni 17 par. 3 i LZP-së parasheh se *“Zyra i bënë rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje”*. Neni 17 par 4 i LZP-së parasheh se *“pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose e refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve”*.

Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 të KQZ-së për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, përkatësisht në nenin 2 pika 2 shprehimisht parashihet që *“Pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja (PZAP) konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjokat e shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjokat e shqiptuara nga KQZ apo është sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe funksionimi partive politike”*.

Në rastin konkret Paneli vërtetoi se Lista Srpska, ka dorëzuar aplikimin e kompletuar, në përputhshmëri bazuar në nenet 16 dhe 17 të LZP-së, dhe KQZ-ja është e obliguar që të certifikoj çdo subjekt politik i cili i plotëson kushtet e parapara ligjore siç i ka plotësuar në rastin konkret subjekti politik Lista Srpska, për çka e njëjta është rekomanduar për certifikim edhe nga Zyra për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ.


Andaj Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, 131 paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet “Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala”*”.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se njoftimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në, që të zbatoj vendimin e PZAP-it konform dispozitës se nenit 118 par. 5 të LZP-së.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 lidhur më nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A.nr.12/2024, datë: 25.12.2024

Kryesues i Panelit  
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.